



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 3646/ Prot. Tiranë, më 16.08.2022

Nr. 283/2 Prot. Tiranë, më 11.08.2022

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 9, Datë 11 / 08 /2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 8, DATË 30.06.2022, "PËR
MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2022 – 2023"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,

URDHËROJ

1. Në kalendarin e miratuar sipas urdhrit të përbashkët nr.8, datë 30.06.2022, "Për miratimin e kalendarit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022 – 2023", në shtojcën nr.1, në kolonën e referencave në pikat 6, 8, 9 dhe 10 të kreut IV/3 të udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, i ndryshuar, bëhen ndryshimet sa më poshtë:

Kreu IV/1, IV/2, IV/3, IV/4, IV/5, IV/6

Shtojca nr. 1

Tabela 1: Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit sipas referencave në Udhëzimin

<i>Nr.</i>	<i>Referenca në Udhëzimin</i>	<i>Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit</i>	
Kreu IV/3			
		Ishte	Bëhet
20	Kreu IV/3, pika 6	13.09.2022	Sipas afateve të përcaktuara nga vet IAL-të
21	Kreu IV/3, pika 8	16.09.2022	Sipas afateve të përcaktuara nga vet IAL-të
22	Kreu IV/3, pika 9	18.09.2022	Sipas afateve të përcaktuara nga vet IAL-të
23	Kreu IV/3, pika 10	26.09.2022	Sipas afateve të përcaktuara nga vet IAL-të

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Aurora BALLIU



Për Qendrën Ndërinstitucionale

të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtor i Përgjithshëm

Z. Arjan XHELIAJ

